



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ROSKOVEC

KRYETARI

Nr. 4406 Prot.

Roskovec, më 11.07.2023

NJOFTIM

PËR

**VEND TË LIRË PUNE PËR POZICIONIN “EDUKATORE” NË ÇERDHEN PUBLIKE
BASHKIA ROSKOVEC**

Në mbështetje të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë; Ligjit nr.139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”, neni 64 , gërma “g” ; Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 97, datë 23.12.2022 “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë dhe të Ndërmarjeve vartëse për vitin 2023”; Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 98, datë 23.12.2022 “Për miratimin e buxhetit, numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë dhe të Ndërmarjeve vartëse të bashkisë për vitin 2023”, miratuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresë nr. 02/1 prot. datë 06.01.2023, si dhe Vendimit të Kryetarit të Bashkisë Nr. 11, datë 16.01.2023 “Për miratimin e strukturës organizative dhe pagat përkatëse të Bashkisë Roskovec dhe Njësive Administrative Kuman, Kurjan dhe Strum, për vitin 2023”,

Bashkia Roskovec shpall 2 (dy) vende të lira pune në pozicionin “Edukatore” në Çerdhen Publike Roskovec.

A. Disa nga detyrat funksionale të “Edukatores së Çerdhes” janë:

Është punonjës në varësi të Përgjegjësit të Çerdhes dhe Përgjegjësit të Arsimit dhe Shendetësisë. Detyrat dhe përgjegjësitë e tij janë:

1. Kujdeset çdo ditë për fëmijët, në drejtim të higjenës personale, të ushqyerit, të ndërruarit e veshmbathjeve, edukimit shoqëror.
2. Planifikon dhe realizon aktivitete që përmbushin nevojat fizike, intelektuale, emocionale dhe sociale të fëmijëve.

3. Në bashkëpunim me specialistët e sektorit psiko-social ndihmon në stimulimin e fushave të zhvillimit të fëmijës si psh: zhvillimi fizik, psiko-emocional, si dhe përdor metoda të efektshme për inkurajimin e zhvillimit fizik, social, emocional, gjuhësor dhe edukativ të fëmijëve 0-3 vjeç.
4. Monitoron gjendjen shëndetësore të fëmijëve gjatë gjithë qëndrimit në çerdhe, njofton në kohë përgjegjës të çerdes dhe përgjegjës të arsimit për problemet shëndetësore të konstatuara dhe i pasqyron ato në filtrin ditor.
5. Siguron që fëmijet të marrin ushqimin sipas mënës ditore.
6. Përgatit planet javore dhe mujore të aktiviteteve.
7. Përpilon çdo ditë raportin lidhur me ecurinë e fëmijëve.
8. Njeh dhe zbaton programin e edukimit të fëmijëve sipas formatit të përcaktuar.
9. Në bashkëpunim me psikologun/punonjës social ndjek planin individual të ecurisë dhe zhvillimit të fëmijëve me nevoja të veçanta.
10. I raporton me shkrim turnit pasardhës, lidhur me problematikat e konstatuara tek fëmijët.
11. Mban përgjegjësi për rregullin dhe higjenën brenda grupit.
12. Merr pjesë në pastrimin e përgjithshëm të çerdes në rast të lyrjes, dezinfektimit apo pastrimit gjeneral të ambienteve të brendshme dhe të jashtme.
13. Krijon një mjedis të përshtatshëm duke përdorur mjete didaktike/vizatime/figura referuese/punime dore etj, për zhvillimin e programit të edukimit për fëmijët 6 muaj -3 vjeç.
14. Informon rregullisht prindërit për ecurinë e fëmijës gjatë qëndrimit në çerdhe.
15. Duhet të jetë e pajisur me çertifikatën e vlefshme për dhënien e ndihmës së parë nga subjekte të liçuara kombëtare/ndërkombëtare.
16. Të zbatojë orarin zyrtar, disiplinën dhe etikën profesionale në punë.
17. Zbaton dhe kryen detyra të tjera të ngarkuara nga Përgjegjësia e Çerdes.

B. Kriteret e punësimit të “Edukator Çerdheje”

- Të ketë mbaruar arsimin e lartë Parashkollor/ Cikli i Ulët/ Punë Sociale / Psikologji/ Infermieri ose Programin e studimit 2-vjeçar me karakter profesional për zhvillimin dhe edukimin e fëmijërisë së hershme (grupmosha 0-3 vjeç) ose arsimin e mesëm.
- Të ketë eksperiencë pune në lidhje me fëmijërinë e hershme (grupmosha 0-3 vjeç).

C. Dokumentat që duhet të dorëzojnë të interesuarit, janë si më poshtë:

- Kërkesë për aplikim,
- Curriculum Vitae,
- Vërtetim banimi
- Çertifikatë personale dhe familjare
- Dëftesë/ Diplomë + listë notash (kopje të noterizuara)
- Çertifikata, kualifikime etj (nëse dispononi)

- Librezë pune origjinale
- Raport mjeko – ligjor
- Dëshmi penaliteti

Afati i fundit i paraqitjes së aplikimeve është më datë 21.07.2023.

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë ose dorazi në Sektorin e Zyrës me Një Ndalesë të bashkisë Roskovec.

KRYETARI
Majlinda Bufi

